



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË

VENDIM

Nr.7 datë 20.06.2025

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr. 15 datë 17.02.2020, Neni 27, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 20/06/ 2025;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 26/06/2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Dino Selimi

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Vladimir BAKIAJ

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Mjaftoni ZERAJ





BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.7 prot.

Tepelenë, më 20.06.2025

Procesverbal

I mbajtur sot me datë 20.06.2025 ora 10.00 në zyrën e këshillit bashkiak me Kryesinë e Këshillit pët të diskutuar rendin e ditës dhe datën e mbledhjes

Marrin Pjesë:

1. Arben Gumeni
2. Mjaftoni Zeraj
3. Vladimir Bakiaj

Rendi i ditës së mbledhjes së këshillit në baze të p/vendimeve që cdo drejtori ka dërguar tek Sekretari i Keshillit.

Data e mbledhjes;

Këshillit Z.Arben Gumeni sygjeron që datë për mbledhjen e radhës te lihet datë 26.06.2025.

U miratua data e mbledhjes datë 26.06.2025.

1. Rendi i ditës si më poshtë: Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluara datë 30.05.2025.
3. **Projektvendim:** : “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Maj 2025”.
4. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Maj 2025”.
5. Raportim nga MZSH “Mbi masat e mara për parandalimin e zjarreve dhe perballimin e emergjencave civile gjatë sezonit turistik ne territorin e Bashkise Tepelenë.”

6. Çështje të tjera.

Të pranishmit e miratuan këtë rend dite.
N/Këshillit falenderon të pranishmit.
Mbyllet mbledhja e Kryesisë

Sekretar i Keshillit
Valbona Çela

